



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:252402
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05738450

Ac.nr.7517/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Halide Reka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit B... H... nga Prishtina, lagja “A...”, rruga “F... C...”, nr. 67, objekti 6/2, kundër debitorit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Prishtinë, me objekt të përmbarimit -vendimi i Inspektoratit të Punës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.1404/21, të datës 23.09.2022, jashtë seance me dt.27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit B... H... nga P..., lagja “A...”, rruga “F... C...”, nr. ..., objekti .../..., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.1404/21, të datës 23.09.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin për lejimin e përmbarimit të kreditorit B... H... nga P..., i parashtruar me datë 03.11.2021.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, kreditori ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet si e themeltë ankesa e kreditorit B... H... nga P..., të mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor dhe të anulohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Cpc.nr.1404/21 i datës 23.09.2022.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditorit.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtares individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 03.11.2021, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar propozim për lejimin e përmbarimit në bazë të titullit ekzekutiv - Vendimit të Inspektoratit të Punës të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë Nr.01/50-19/21, të datës 20.01.2021.

Gjykata Themelore në Prishtinë duke vendosur lidhur me propozimin për përmbarim me aktvendimin e ankimuar Cpc.nr.1404/21 të datës 23.09.2022 e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin për lejimin e përmbarimit të kreditorit B... H... nga Prishtina, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës ka gjetur se dokumenti përmbarues mbi bazën e të cilit kreditori e ka ushtruar propozimin për lejimin e përmbarimit është i pa përshtatshëm për përmbarim, sepse në bazë të pikës I të dispozitivit të vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.01/50-19/21 datë 20.01.2022, është obliguar këtu debitori që të publikojë në Buletinin e Universitetit të Prishtinës ‘‘Hasan Prishtina’’ në Prishtinë, Raportin Pozitiv të Komisionit recenzues dhe vendimin e Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë për zgjedhjen e B... H... Profesor Asistent në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës ‘‘H... P...’’ në Prishtinë, për lëndët: Mjekësia e Sportit, Bazat e transformimit motorik III, Bazat e transformimit motorik I dhe II, Masazhe Mjekësore, Menaxhimin në Fizioterapi dhe Praktikë Klinike, mirëpo në këtë rast nuk është e qartë se cilin raport të komisionit recensues dhe cilin vendim të këshillit të fakultetit të mjekësisë duhet ta publikojë debitori pasi që në dispozitivin e këtij vendimi nuk është cekuar numri i raportit dhe as numri i vendimit dhe datat e lëshimit të tyre. Prandaj në mungesë të këtyre të dhënave ky vendim është i pa përshtatshëm. Me nenin 27, par.1 të LPP-së, është rregulluar se një dokument përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim, në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përbushjes së detyrimit dhe rrjedhimisht jo çdo vendim përmbarimor është titull ekzekutiv, në kuptimin që të jetë objekt i ekzekutimit të detyrueshëm, e në rastin konkret Vendimi i Inspektoratit të Punës me Nr.01/50-19/21 datë 20.01.2022 nuk është i përshtatshëm sepse nuk i përmban këto elemente, pra në mungesë të caktimit të objektit të saktë të detyrimit, ai është i papërshtatshëm për përmbarim.

Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar drejtë, e të cilat shkaqe ankimore Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbarimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbarim, konform dispozitave ligjore në fuqi. Sipas vlerësimit të Gjykatës

së Apelit, në rastin konkret dokumenti përmbartimor është i papërshtatshëm për përmbartimor edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP, në mënyrë shprehimore është paraparë se “*dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartimor në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartimor. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përmbartimor-vendimi administrativ i Inspektoratit të Punës Nr.01/50-19/21 datë 20.01.2022, në dispozitiv të tij nuk e përmban 9 nuk ka të caktuar) objektin e saktë të detyrimit, në rastin konkret nuk është e qartë se cilin raport të komisionit recensues dhe cilin vendim të këshillit të fakultetit të mjekësisë duhet ta publikojë debitori pasi që në dispozitivin e këtij vendimi nuk është cekuar numri i raportit dhe as numri i vendimit dhe datat e lëshimit të tyre, për çka nuk kuptohet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë, andaj Gjykata e Apelit si gjykatë ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar propozimin përmbartimor si të pa bazuar.

Po ashtu, Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihat në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe se Gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe Gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7517/2022, datë, 27.05.2024

Gjyqtarja

Halide Reka